

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Auditim

P6

Data 06/10/2018

Detyra 1

(a) ISA 315 Identifikimi dhe vlerësimi i rreqizeve të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij thekson 'auditori duhet të kryej...procedura të vlerësimit të rrezikut për të përftuar njohuri për entitetin dhe mjedisin e tij, përfshirë kontrollet e brendshme'.

Kërkohe:

Diskutoni qëllimin e procedurave të vlerësimit të rrezikut dhe shpjegoni burimet kyçe të evidencave të auditimit të cilat mund t'i përdorë auditori si pjesë e procesit të vlerësimit të rrezikut. (6 pikë)

(b) Alfa & Ko, është një firmë e auditimit me katër partner. Firma ka një numër të klientëve të auditimit në sektorë të ndryshëm.

Ju jeni senior i auditimit dhe partneri ju ka deleguar punën e planifikimit të auditimit për klientin Telenorma Shpk. Kompania ofron një gamë të gjërë të shërbimeve të komunikimit celular dhe ky do të jetë viti i dytë i angazhimit të firmës tuaj në këtë kompani për shërbime të auditimit.

Ju sapo keni takuar drejtorin financiar të kompanisë për tu dakorduar për kushtet e angazhimit. Drejtori financiar ju informoj se kompania është duke u rritur shpejtë që ka shkaktuar që sistemet e kontabilitetit të ndryshohen si dhe vështirësi në mirëmbajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshme.

Kompania gjithashtu ka kërkuar nga firma juaj të ofroj shërbime të rishikimit të implementimit të sistemit të kontrolleve të brendshme. Kompania ka themeluar një department të auditimit të brendshëm dhe dëshiron që ju ta kufizoni punën tuaj të auditimit të jashtëm vetëm duke përdorur punën e auditimit të brendshëm.

Ju gjithashtu keni kuptuar se Telenorma do të prezantoj në shitje një telefon të ri celular i cili është në gjendje të ndërhyjë në shërbimet emergjente të vendit. Statusi ligjor i këtij produkti është i paqartë dhe zhvillimi i tij nuk është publikuar.

Drejtori financiar ka treguar se mund të kërkoj nga firma e auditimit të ofrojnë një raport të rishikimit për parashikimin e rrjedhës së parasë së kompanisë si kërkesë kontraktuale që ka me ofruesin e franshizës së Telenorma për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018.

Kërkohe:

Si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut për auditimin e Telenorma për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, analizoni çështjet që duhet të konsiderohen kur ofrohen këto shërbime për klientin. (10 pikë)

(c) Shpjegoni çka nënkuptohet me rrotacion të auditorëve dhe cilat janë përfitimet dhe pengesat e supozuara. (4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Përgjigja

(a) Procedurat e vlerësimit të rrezikut

(i) Qëllimi kryesor i procedurave të vlerësimit të rrezikut është të ndihmojë auditorin në njohjen me klientin.

Procedurat do të ofrojnë evidence të auditimit lidhur me vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale në pasqyrat financiare të klientit.

Auditori po ashtu do të përftojë evidencat fillestare lidhur me klasët e transaksioneve të klientit dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Në fund, auditori do të identifikojë rreziqet në fushat tjera siç është çështja e pavarësisë me klientin.

(ii) Auditori mund të përftojë dëshmi përmes:

- Bisedave me menaxhmentin dhe te tjerët që janë të lidhur me entitetin siç janë juristët ose ekspertët për vlerësime
- Procedurat analitike përfshirë analizën e koeficientëve për të përftuar të dhëna të nivelit të lartë për klientin
- Vëzhgimi i aktiviteteve të entitetit dhe inspektimi i dokumenteve, etj.

(b)

Kompania kërkon një gamë të gjërë të shërbimeve përfshirë rishikimin e implementimit të sistemeve të kontrollit. Ofrimi i këtyre shërbimeve paraqet rreziqe në këto fusha:

Aftësitë e nevojshme

Auditori duhet të kontrollojë nëse mund të ofroj këto shërbime. Firma e auditimit i ka vetëm 4 partnerë prandaj duhet të sigurohet se ka personel të mjaftueshëm dhe me kompetencë.

Kërcënimi i vetërishikimit

Nëse firma e auditimit vendos të implementoj sistemet e reja të kontrollit ata po ashtu edhe do ti auditonin ato si pjesë e auditimit ligjor. Firma e auditimit duhet të sigurohet se personeli i cili implementon sistemet është i ndryshëm nga personeli i auditimit. Do të ishte e preferueshme që këto të kryhen nga departamente të ndara. Nëse firma nuk ka personel të mjaftueshëm, atëherë duhet ta refuzojnë angazhimin për sistemet.

Pranimi i angazhimit jo-auditues

Ka mundësi që firma e auditimit është duke shkelur parimet e kodit të etikës duke pranuar punët tjera joaudituese. Firma duhet të sigurohet se është duke vepruar në pajtueshmëri me kodin e etikës për të limituar kërcënimin e vetërishikimit.

Të hyrat nga tarifat

Pranimi i punës shtesë do të rezultojë me të hyra shtesë nga tarifat. Kodi i etikës nuk lejon që tarifat nga një klient që nuk është i listuar në bursë të tejkalojnë 15% të të yrave totale të firmës.

Rritja e klientit

Kompania është duke u rritur shpejtë. Kompania ka kontrolle të dobëta të brendshme që e rrit rrezikun e anomalive në pasqyrat financiare. Firma e auditimit duhet të sigurohet se ka personel me përvojë të përshtatshme dhe kohë të mjaftueshme për ti kryer procedurat e auditimit.

Auditimi i brendshëm

Pritjet e klientit që të përdoret puna e auditimit të brendshëm mund të jetë e vështirë për tu përmbushur. Si departament i ri, do ti nevojitet kohë departamentit të auditimit të brendshëm të kuptojë sistemet e kompanisë dhe të prodhojë raporte të dobishme. Pritjet për zvogëlim të tarifës së auditimit duhet të menaxhohen me kujdes nga firma e auditimit duke u siguruar se puna nuk limitohet.

Kërcënimi i shoqërimit

Kompania është duke prodhura një telefon të ri. Statusi ligjor i këtij telefoni është i pasiigurt; mund të jetë diçka e kundërligjshme.

Firma e auditimit duhet të përcaktojë mundësinë nëse telefoni është i kundërligjshëm. Firma duhet të mos shoqërohet me kompaninë e cila prodhon produkte të kundërligjshme.

Raporti mbi rrjedhën e parasë

Kompania duhet të dorëzojë edhe një raport mbi parashikimin e rrjedhës së parasë. Ky duhet të jeta angazhim i veçantë me rrezik për firmën e auditimit sepse klienti mund të përpiqet të paraqes pozitë joreale të parasë në këtë parashikim. Firma e auditimit duhet të përcaktoj se çfarë raporti saktësisht duhet të rishikojë dhe të sigurohet se kanë personelin dhe kohën e nevojshme për të kryer këtë angazhim.

Problemi i mundshëm me hipotezën e vijimësisë

Nuk është e qartë nëse dështimi për të marrë licencën për telefonin e ri do të rezultojë me problem me hipotezën e vijimësisë. Firma e auditimit duhet të rishikojë parashikimet e parasë së gatshme për të përcaktuar gjendjen e kompanisë në të ardhmen.

(c) Rotacioni i auditorëve

Rotacioni është term i cili përdoret për të limituar numrin e viteve që një individ ose firmë e auditimit mund të shoqërohet me një klient të caktuar.

Kodet e etikës rekomandojnë që personeli i auditimit nuk duhet të shoqërohet për shumë vite me klientin.

Përfitimi i njohjes me biznesin e klientit nuk duhet të tejkalojë humbjen e mundshme të skepticizmit profesional.

Më tutje argumentohet se firmat e auditimit duhet të kenë angazhim të caktuar me vite te klienti.

Përfitimi i sigurimit të ndonjë pune shtesë joaudituese te klientët e auditimit, zvogëlohet nëse auditori nuk shoqërohet më gjatë me klientin, psh shtatë vite.

Ngjashëm, përpjekjet për të ruajtur marrëdhënie të mira me menaxhmentin deri në atë masë sa të certifikohen pasqyrat financiare jo të drejta, nuk do të shërbente më qëllimit.

Argumentet kundër rotacionit të firmave të auditimit janë lidhur me koston shtesë për kompanitë.

Është viti i parë i angazhimit i cili i kushton më së shumti auditorit dhe i cili përbën rrezik më të madh në moszbulimin e anomalive materiale për shkak të mosnjohjes së klientit. Rotacioni i auditorëve kërkohet me ligj në shumë vende.

Detyra 2

Kontabilisti i kompanisë Dora Shpk, ju ka ofruar informatat në vijim lidhur me lëvizjet e pasurive joqarkulluese të kompanisë për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017.

	Toka €'000	Pajisjet €'000	Gjithsej €'000
Kosto			
Gjendja me 1 janar 2017	1,600	1,600	3,200
Shtesat	-	-	-
Rivlerësimi	240	240	480
Heqjet / Shitjet	-	1,600	1,600
Gjendja përfundimtare me 31 dhjetor 2017	1,840	1,300	3,140
Zhvlerësimi i akumuluar			-
Gjendja me 1 janar 2017	-	720	720
Shpenzimet e zhvlerësimit gjatë vitit	-	272	272
Heqjet / Shitjet	-	- 50	- 50
Gjendja përfundimtare me 31 dhjetor 2017	-	942	942
Vlera neto në libra me 31 dhjetor 2017	1,840	358	2,198

Pajisjet zhvlerësohen me 20% në vit, duke ngarkuar zhvlerësimin e plotë në vitin e blerjes dhe asnjë zhvlerësim në vitin e shitjes së pasurisë.

Kjo është hera e parë që kompania rivlerëson tokën. Rivlerësimi është kryer nga një firmë me renome e vlerësuesve, që keni njohuri për ata.

Kompania mban një regjistër të pasurive joqarkulluese e cila është harmonizuar me ekstraktin e mësipërm.

Kërkohet:

(a) Përshkruani kontrollet kyçe të brendshme të cilat duhet të jenë në funksion sa i përket regjistrin të pasurive joqarkulluese para se të mbështeteni në të si burim i evidencave të auditimit.

(4 pikë)

(b) Çfarë pune e auditimit duhet të kryhet për shpenzimin e zhvlerësimit dhe gjendjen e zhvlerësimit të akumuluar. (4 pikë)

(c) Shpjegoni testet relevante të cilat duhet të kryhen lidhur me shtesat dhe heqjet/shitjet e pajisjeve. (8 pikë)

(d) Diskutoni rreziqet specifike të auditimit të cilat mund të paraqiten për shkak të rivlerësimit dhe shpjegoni shkurtimisht punën e auditimit që duhet të kryhet për të adresuar këto rreziqe.

Mund të supozoni se klienti e ka trajtuar si duhet rivlerësimin në kontabilitet.

(4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Përgjigja

(a) Kontrollat kyçe për regjistrin e pasurive joqarkulluese

1. Regjistri i pasurive duhet të mbahet nga personel i pavarur nga ruajtja dhe autorizimi i blerjeve ose shitjeve/hqejeve nga përdorimi i pasurive joqarkulluese.
2. Regular reconciliation of the FAR to the nominal ledger është investigation and accounting for all the differences.
3. Duhet të ketë autorizime të regjistrimit të shtesave dhe heqjeve nga regjistri, psh forma të paranumëruara, të nënshkruara nga menaxhmenti.
4. Numrim i rregullt fizik i pasurive joqarkulluese dhe harmonizim me regjistrin.
5. Kontrollat mbi lëvizjet dhe regjistrimet e pasurive joqarkulluese për të siguruar se të gjitha lëvizjet janë regjistruar

(b)

1. Rishikimi i politikave të zhvlerësimit në përputhje me industrinë, SNRF dhe rezultatin e heqjes nga përdorimi i makinerive. Nëse shitjet e pasurive gjenerojnë fitim, kjo tregon se zhvlerësimi është i tepërt.
2. Rishikimi i supozimeve lidhur me jetën ekonomike dhe vlerën e mbetura? A janë të arsyeshme?
3. Rishikimi i llogaritjes së zhvlerësimit. A është i saktë? A përputhen shifrat nga libri kryesor me shifrat në regjistrin e pasurive?
4. A është i përshtatshëm zhvlerësimi i akumuluar? A ka indikacion për dëmtim të pasurive? A është bartur shifra e vitit të kaluar saktë në këtë vit?

(c)

Shtesat:

1. Plotësia. A përputhet lista me regjistrin e pasurive?
1. Kontrolloni regjistrimet në kontabilitet për gabime në klasifikim – kapitalizim kundrejt shpenzimit i riparimit dhe mirëmbajtjes
2. Testoni në bazë të mostrës autorizimet, dmth a janë autorizuar nga niveli i duhur i menaxhmentit?
3. Testoni në bazë të mostrës ruajtjen e pasurive, dmth ekzistencën. A ekziston pasuria dhe a përdoret nga klienti. Inspektori fizikisht pasurinë.
4. Testoni vlerësimin. A janë regjistruar shtesat, ndjekni blerjet deri te faturat dhe a janë klasifikuar i duhet. Kjo poashtu mbulon edhe pohimin e të drejtave dhe detyrimeve dhe paraqitjes.

Heqjet nga përdorimi/shitjet e pasurive joqarkulluese:

1. Kontrolloni autorizimin e shitjeve
2. Kontrolloni listën e shitjeve për të testuar plotësinë. A përputhet lista me detajet nga regjistri i pasurive?
3. A janë regjistruar të gjitha shitjet në kontabilitet?
4. Kontrolloni nëse shitjet NUK ekzistojnë. Kontrolloni a janë kontabilizuar si duhet të hyrat nga shitja e pasurive joqarkulluese.

(d) Rivlerësimi

1. Rreziku: A është i kualifikuar vlerësuesi, përndryshe vlerësimi mund të mos jetë i vlefshëm.

Përgjigja: Kontrolloni nëse vlerësuesi është anëtarë i ndonjë organizate profesionale, ka përvojë dhe reputacion dhe është i pavarur nga kompania.

2. Rreziku: Rivlerësimi është i bazuar në supozime joreale dhe të dyshimta që do të thotë se nuk është i arsyeshëm.

Përgjigja: shikoni udhëzimet e shkruara që i janë dhënë vlerësuesit lidhur me qëllimin dhe objektin e punës. A janë supozimet e arsyeshme dhe çfarë burime të pavarura të informatave ka përdorur vlerësuesi.

Detyra 3

Firma juaj e auditimit CFA Audit sapo ka marr një klient të ri, La-La Shpk, një klub i shëndetit (qendër fitnesi) që operon me anëtarësi ose me pagesë aty-për aty. La-La e cila ka filluar biznesin në vitin 2010, është përballur me konkurrencë në dy vitet e fundit nga klubi Gjim Shpk, i cili operon vetëm me anëtarësi. Juve sapo ju kanë informuar se firma juaj e auditimit ka pranuar thirrjen për ofertim për auditim nga kompania që është pronare e Gjim Shpk.

Drejtori menaxhues i La-La Shpk, Artani është shok i shkollës së menaxherit të auditimit. Kjo ishte edhe mënyra se si firma juaj e auditimit e kishte marrë La-La si klient të auditimit. Ju jeni caktuar si senior i auditimit në angazhimin për La-La.

Në vizitën e fundit të Artanit në zyrën tuaj, ai theksoi se dëshiron të ofroj që i gjithë personeli i CFA Audit të mund të blej anëtarësinë në klub me 50% zbritje dhe që do të ju mundësonte një zbritje prej 75% në klasë të veçanta.

Ai propozoi që ju të bëheni anëtar i bordit të drejtorëve të La-La si drejtor joekzekutiv. Përveç kësaj, ai propozoi që firma juaj, si pjesë e auditimit, të konfirmojë shifrat financiare të kërkesës për dëmshpërblim që i kishte dorëzuar La-La te kompania e sigurimit si rezultat i një vërshimi nga pëlçitja e gypave të ujit në klub. Gypat kishin pëlçitur në pjesën kryesore të qendrës së fitnesit mu para përfundimit të vitit.

Kërkohet:

(a) Në kontekstin e skenarit të mësipërm:

(i) Vlerësoni kërcënimet etike (reale ose të perceptuara) të cilat mund të ndikojnë në pavarësinë e firmës tuaj në auditimin e La-La; dhe (8 pikë)

(ii) Për secilin kërcënim rekomandoni si mund të eliminohet ose zvogëlohet në nivel të kënaqshëm. (8 pikë)

(b) Diskutoni përfitimet që mund të ketë një kompani nga komiteti i auditimit. (4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Përgjigja

Kërcënimi	Menaxhimi i kërcënimit (8 total)
<p>Zbritjet e ofruara për personelin e auditimit-kërcënim i interesit vetiak Një përfitim i tillë mund të shkaktoj kërcënim të interesit vetiak sepse përanuesi nuk don ta humb këtë përfitim prandaj mund humb paanësinë gjatë auditimit dhe të mos kërkojë korrigjim nga menaxhmenti nëse ka anomali materiale në PF.</p>	<p>Auditorët nuk lejohen të pranojnë përfitime të tilla përveç nëse vlera e tyre është qartë jomateriale. Në këtë rast, vlera e zbritur e anëtarësisë nuk ka gjasë të jetë jomateriale për personelin e auditimit, prandaj firma e auditimit duhet ta refuzojë këtë ofertë.</p>
<p>Partneri është ftuar të bëhet anëtar i bordit të kompanisë – kërcënim i familiaritetit, interesit vetiak Nëse partneri bëhet anëtar i bordit të kompanisë, ka rrezik që ai të fillojë të identifikojë veten si shumë të afërt me kompaninë. Poshtu ka rrezik që partneri mund të fillojë të merr role menaxheriale.</p>	<p>Auditorëve nuk u lejohet të verpojnë sei drejtorë të klientëve të tyre prandaj partneri duhet ta refuzoj me mirësjellje këtë ofertë.</p>
<p>Siguria lidhur me kërkesën për dëmshpërblim – kërcënim i avokimit Firma e auditimit do të duket se është duke vepruar në emër të kompanisë</p>	<p>Auditorët duhet të jenë të kujdesshëm me kërkesa të tilla pasi që i vendos në pozitën e mbrojtësit të pozicionit të klientit. Kodi i etikës nuk u lejon auditorëve të promovojnë pozitën e klientit të tyre.</p>
<p>Konflikti i interesit Firma e auditimit është ftuar të ofertoj për shërbime të auditimit te konkurrenca e klientit të tyre. Edhe pse kjo nuk është e ndalura, megjithatë klientët mund të konsiderojnë si kërcënim ndaj konfidencialitetit prandaj mund të kërkojnë ngazhim të auditorëve tjerë në këto raste.</p>	<p>Firma e auditimit duhet të shpalos këtë fakt ndaj klientit. Nëse ata janë të pakënaqur me këtë fakt auditorët duhet të zgjedhin se në cilin angazhim do të marrin pjesë. Në rast se nuk paraqet problem, auditorët duhet të sigurohen se ekipet auditimit janë plotësisht të ndara nga njëri angazhim në tjetrin për të ruajtur konfidencialitetin e informtave të përfitura gjatë auditimeve.</p>

Përfitimet e komitetit të auditimit

- (i) Një anëtarë i komitetit të auditimit duhet të ketë përvojën relevante financiare prandaj ky fakt e përmirëson kredibilitetin dhe objektivitetin e pasqyrave financiare.
- (ii) Drejtorët joekzekutiv si anëtarë të komitetit të auditimit do ta lirojnë kohën e drejtorëve tjerë ekzekutiv për tu fokusuar në aspektet tjera të biznesit.
- (iii) Komiteti i auditimit ofron një organ të pavarur për auditorët për tu këshilluar në rast se ka çështje që kërkojnë gjykim dhe të cilat mbesi të pagjdhura nga drejtorët.
- (iv) Komiteti i auditimit monitoron objektivitetin dhe pavarësinë e auditorëve të jashtëm.
- (v) Komiteti i auditimit është pikë reference për funksionin e auditimit të brendshëm pasi që ata do të monitorojnë punën e auditimit të brendshëm dhe takohen në baza të rregullta me për të siguruar se puna kryhet dhe mbikqyret me efektivitet.

Detyra 4

Ju jeni caktuar si senior i auditimit në angazhimin për auditim të kompanisë Enriko Shpk për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017.

Enriko Shpk paketon dhe shet lëngje të ndryshme të frutave me emrin tregtar Jojo. Kompania po ashtu furnizon edhe shumë supermarkete. Ju jeni duke u njohur me entitetin në fazën e planifikimit të auditimit duke lexuar shënimet në vijim, që janë përgatitur nga menaxheri i auditimit.

“Viti 2017 ishte vit i trazuar për kompaninë Enriko. Margarita Enriko e cila ishte pronare dhe udhëhiqte biznesin, u pensionua papritmas në fillim të vitit 2017. Kompania tani udhëhiqet nga tre fëmijët e saj, të tretë janë në moshat 20 vjeçare dhe shumë pa përvojë. Nga rishikimi i procesverbalëve të takimeve të menaxhmentit u vërejt se ka mospajtime të mëdha lidhur me strategjinë dhe aktivitetet operative të kompanisë dhe mënyrën e udhëheqjes. Kompania kishte blerë një fabrikë në shkurt të vitit 2017, e cila ishte financuar përmes rritjes së nivelit të mbitërheqjes bankare. Përmes kësaj blerje, kompania kishte plan të zgjeronte gamën e produkteve të lëngjeve gjatë vitit 2017. Mirëpo, kishte shumë problem që të vihej në funksion fabrika e re. Pasqyrat financiare draft për vitin 2017 paraqesin sasi të mëdha të stoqeve të produkteve të gatshme si dhe humbje domethënëse si rezultat i shpenzimeve të larta të marketingut, që duket se ishin të pasuksesshme për të rritur shitjen e lëngjeve. Kompania po ashtu u ballafaqua me rënie të madhe të marzhës së fitimit bruto për shkak të rënies në këmbimin valuator Euro-Dollar, pasi që lënda e parë blihet nga Brazili me Dollar. Rritja e konkurrencës në mes të supermarketeve shtyu kompaninë të zvogëlonte çmimet e produkteve të saj. Gjithashtu, supermarketeve tani ju duhet kohë më e gjatë për të shlyer borxhet ndaj Enriko.”

Kërkohet:

- (a) Cila është përgjegjësia e auditorit lidhur me zbatueshmërinë e hipotezës së vijimësisë. (4 pikë)
- (b) Përshkruani faktorët që duhet të konsiderohen në përcaktimin nëse Enriko është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)
- (c) Rekomandoni punën e auditimit që duhet të kryhet për të vlerësuar nëse hipoteza e vijimësisë është e përshtatshme për kompaninë Enriko. (10 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Përgjigja

(a) Përgjegjesia e auditorit

1. A është hipoteza e vijimësisë e përshtatshme
2. A ekzistojnë pasiguri materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë që duhet të shpalosen. (4)

(b) Treguesit e problemeve të mundshme me vijimësisë:

1. Menaxhmenti i ri papërvojë që nuk dinë të udhëheqin biznesin.
2. Financimi i fabrikës së re duke përdorur overdraftin, që mund të kërkohej të kthehet në çdo kohë nga banka.
3. Rritja në stoke që mund të prishen dhe të mos shiten fare.
4. Degradimi i marzhave të fitimit për shkak të ndikimit në normat e këmbimit. Nëse kjo vazhdon klienti mund të operojë me humbje dhe të ballafaqohet me vështirësi financiare.

(c) Puna e auditimit – hipoteza e vijimësisë

1. Bisedat me menaxhmentin lidhur me opinionin e tyre për kërcënimet aktuale dhe mënyrën si do të adresohen;
2. Rishikimi i informatave financiare, psh buxheteve dhe parashikimeve të parasë;
3. Planifikimi i procedurave për të identifikuar kërcënimet ndaj vijimësisë në një të ardhme të parashikueshme.

Auditimi i vlerësimit të menaxhmentit i hipotezës së vijimësisë (HP):

1. Procesin të cilin e ka ndjekur menaxhmenti për të vlerësuar HP;
2. Supozimet mbi të cilat është bazuar vlerësimi;
3. Planet e menaxhmentit në të ardhmen;
4. A është përdorur e gjithë informata që është në dijeni auditori, për të kryer vlerësimin;
5. A mbulon plani periudhën e parashikueshme – së paku 12 muaj nga fundi i vitit;
6. A ka sistem për të informuar për rreziqet dhe kërcënimet në të ardhmen;
7. Arsyeshmëria e supozimeve kyçe të përdorura në buxhetim dhe parashikim të parasë;
8. Ndjeshmëria e buxheteve dhe parashikimeve;
9. Ekzistenca, mjaftueshmëria dhe kushtet e ofruara nga furnitorët dhe kreditorët;
10. Planet e menaxhmentit për tu ballafaquar me çfador kërcënim ose rreziku.

Detyra 5

Ju jeni auditor i jashtëm i kompanisë Alabama Petrol për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017. Kompania ka 12 pika të karburantit dhe secila pikë e ka edhe dyqanin dhe autolarjen.

Secila pikë e karburantit është përgjegjëse për blerjen e stokeve të saj dhe përgatit raporte financiare menaxheriale çdo muaj të cilat dërgohen në departamentin qendror të kontabilitetit në Alabama Petrol.

Faturat e pranuar nga furnitorët e karburanteve dhe mallrave tjera mbahen në secilën pikë të karburantit individualisht. Një përmbledhje e faturave dërgohet në bazë mujore në zyrat qendrore të kompanisë.

Alabama Petrol financohet nga €250,000 kredi bankare që kthehet në vlerë prej €50,000 vjetore për 5 vitet e ardhshme duke filluar nga shtatori i vitit 2018.

Kërkohet:

(a) Shpjegoni çka kuptohet me termin procedura analitike dhe si mund të përodren ato gjatë fazave të ndryshme të auditimit të Alabama Petrol. (4 pikë)

(b) Diskutoni katë procedura analitike që duhet të kryhen gjatë auditimit të të hyrave dhe fitimit të Alabama Petrol. (4 pikë)

(c) Specifikoni procedurat analitike që duhet të kryhen për të verifikuar pohimet në vijim:

– vlerësim i stokeve

– plotësia e të pagueshmeve (8 pikë)

(d) Përshkruani procedurat e pavarura që duhet të kryhen gjatë auditimit të kredisë bankare të Alabama Petrol. (4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Përgjigja

(a) Procedurat analitike

Procedurat analitike kanë të bëjnë me vlerësimin e informatave financiare duke krahasuar të dhënat financiare dhe jofinanciare dhe hetimin e luhajtve/marëdhënieve të cilat janë jokonsistente me informatat tjera.

Ato përdoren në fazën e planifikimit të auditimit për të identifikuar prirjet/variancat e pazakonshme të cilat mund të tregojnë për rreziqe të auditimit.

Ato mund të përdoren si procedura të pavarura për të përfutur dëshmi të auditimit, psh duke rishikuar periudhën e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme nga periudha e tanishme me atë të mëparshmen. Çfardo luhajtje mund të jetë tregues se konsumatorëve ju nevojitet peroudhë me agjatë për të shlyer borxhet dhe kështu ndonjë saldo e LLA mund të ketë nevojë të shlyhet.

Procedurat analitike përdoren në fazën e rishikimit të auditimi për tu siguruar se është grumbullaur dëshmi e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit për të mbështetur çfardo ndryshimi në variancat e paraqitura.

(b) Shembuj të procedurave analitike

Krahasimi i shitjeve mujore të ndara sipas shitjeve të karburanteve, nga dyqanate dha autolarjet dhe krahaso me të njëjtat nga pikat tjera të karburanteve. Heto çfardo luhajtje domethënëse.

Krahasimi i marzhave të fitimit për shitjet e karburanteve për secilën pikë të shitjes.

Përcakto marzhën e ngarkuar të fitimit nga menaxhmenti. Apliko këtë marzhë në kosto dhe vlerëso sa janë shitjet.

Krahaso të hyrat e vlerësuara me ato të regjistruarat dhe heto ndryshimet domethënëse.

Analizo mesataren e ditëve në mbajtjes së stoqeve nga dyqani në dyqan.

(c)

(i) Vlerësimi i stoqeve

Nga një mostër e faturave nga furnitorët, ndjekini deri të kosto stoqeve.

Diskutoni metodën e koston së përdorur për vlerësimin e stoqeve (psh kosto mesatare) dhe krahasoni me çmimet aktuale të karburanteve për tu siguruar se menaxhmenti është duke përdorur vlerësim të duhur.

Përputhni një mostër të shitjeve nga dyqanet me faturat e shitjeve për të konfirmuar nëse VNR është më e lart se kosto.

Për një mostër të stoqeve nga dyqanet, krahasoni me faturat nga furnitorët për të përcaktuar koston.

Përcaktoni nëse vlera e stoqeve për produktet që prishen është e arsyeshme, duke konsideruar afatin e përdorimit.

(ii) Plotësia e të pagueshmeve

Krahasoni të pagueshmet nga viti në vit dhe përcaktoni nëse ka saldo të llogarive të cilat duken artificialisht të ulëta.

Kërkoni që klienti të dërgon letrat e konfirmimeve te furnitorët për të përcaktuar saldon përfundimtare.

Rishikoni kartelat e pranuar nga furnitorët dhe analizoni nëse të gjitha faturat e furnitorëve janë regjistruar në kontabilitet.

Rishikoni librin e parasë për ndonjë pagesë domethënëse ndaj furnitorëve dhe ndjekeni deri te regjistrimi në librin e të pagueshmeve.

Analizoni disa pagesa afër fundit të vitit dhe konsideroni i takojnë periudhës së saktë.

Llogaritni periudhën e pagesës në llogarive të pagueshme dhe krahasoni me vitin e mëparshëm.

Hetoni çfardo lëvije domethënëse.

(d) Procedurat e auditimit për huanë nga banka

Inspektini marrëveshjen e kredise për të verifikuar shumën, normën e interesit dhe kushtet tjera të kredisë përfshirë afatin e kthimit. Nëse ka kushte për tu përmbushur nga entiteti, diskutoni me menaxhmentin nëse nivelet e caktuara janë duke u respektuar.

Përftoni një konfirmim direkt nga banka për të verifikuar saldot përfundimtare të kredisë së papaguar.

Sigurohuni se kredia është shpalosur si duhet në pasqyrat financiare dhe është klasifikuar në pjesën afatshkurt dhe afatgjatë.

Rillogaritni shpenzimet e interesit për vitin dhe verifikoni nëse janë shpalosur si duhet.